



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.91/2025

Paneli Zgjedhor për Ankese dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj Kryesues, Kymete Kicaj, dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhje Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 03.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZL.Anr.91/2025 e datës 01.10.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhje Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 01.10.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën ZL.Anr.91/2025, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se me datë 30.09.2025 është evidentuar serish se subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka vendosur në mënyrë të kundërligjshme materiale propaganduese në infrastrukturë publike, konkretisht në shtyllat e ndriçimit rrugor që janë nën menaxhimin e Ministrisë së Infrastrukturës. Gjatë vrojtimit janë parë mbi 10 lamposta përgjatë rrugës "Agim Kukleci" (Deçan-Pejë), të mbuluara me postera të subjektit AAK, për kryetarin e komunës dhe kandidatët për asamble, si dhe disa sosh përgjatë rrugës "Enver Haradinaj" (Deçan-Pejë) të mbuluara me postera të subjektit të njëjtë.

Vendosja e materialeve zgjedhore në lamposta përbën shkelje të qartë ligjore. Neni 26, par.2 i Ligjit për Rrugët ndalon vendosjen e panove reklamuese dhe materialeve propaganduese në shtyllat e ndriçimit publik. Po ashtu, neni 36 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme ndalon

shfrytëzimin e pasurisë publike për qëllime elektorale, ndërsa Rregullorja Zgjedhore Nr.07/2024 (neni 7, par.2.4 dhe 2,5) ndalon vendosjen e materialeve zgjedhore në objekte publike dhe pasuri shtetërore. Parashtruesi ka bashkangjitur si pove ankesë disa fotografi.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, thekson se pretendimet e paraqitura nga LVV lidhur me shkeljen e Nenit 26 par. 2 të Ligjit për Rrugët nuk mund të shqyrtohen nga PZAP, si edhe është përcaktuar me dispozitën e lartcekur.

Ndërsa këto pretendime për shkelje duhet të paraqiten pranë organeve kompetente siç përcaktohet në Ligjin për Rrugët.

Për më tepër edhe sikur të ishte e lejuar që subjektet të paraqesin ankesa pranë PZAP-së, për shkelje të pretenduara të ligjeve tjera veçmas atyre zgjedhore, në rastin konkret pretendimet e ankuesit nuk qëndrojnë. Kjo për shkak se rrugët "Agim Kukleci" dhe "Enver Haradinaj" në Deçan janë nën administrimin e Komunës së Deçanit, e jo të Ministrisë së Infrastrukturës, ashtu siç gabimisht pretendon ankuesi.

Prandaj, Komuna e Deçanit, duke ushtruar kompetencën e saj mbi rrugët nën administrimin e saj, më datë 25.04.2025 ka lidhur një kontratë për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, ku objekt i saj ka qenë përdorimi i hapësirave publike dhe i hapësirave në ishujt e ndriçimit publik. Kjo kontratë është lidhur ndërmjet Komunës së Deçanit dhe kompanisë "Techno Store" L.L.C.

Ndërkaq, subjekti politik AAK, më datë 10.09.2022, ka lidhur kontratë me kompaninë "Techno Store" L.L.C., për shfrytëzimin e hapësirave reklamuese, me afat nga 12.09.2025 deri më 12.10.2025. Si rrjedhojë, kjo rrethanë e bën plotësisht të ligjshëm vendosjen e materialeve zgjedhore në rrugët e administruara nga Komuna e Deçanit, të cilat i janë dhënë në shfrytëzim kompanisë "Techno Store" L.L.C. Më tej, lidhur me pretendimet për shkelje të Nenit 36 të LZP-së, subjekti politik AAK, thekson se me këtë dispozitë ndalohet përdorimi i resurseve dhe pasurive të institucioneve publike, mirëpo në interpretim të drejtë të dispozitave të LZP-së, shkelja e dispozitës së pretenduar nga LVV mund të konstatohet vetëm nëse nuk është përmbushur parakushti ligjor, përkatësisht, që vendosja e materialeve zgjedhore të bëhet pa pëlqimin e administruesit të hapësirës, dhe se në rastin konkret, është më se e qartë se ky parakusht është përmbushur, pasi që ekziston një kontratë e lidhur në mes të subjektit politik AAK dhe kompanisë e cila ka fituar të drejtën e shfrytëzimit të hapësirave publike nga Komuna e Deçanit, si rrjedhojë kandidatët e AAK-së janë të autorizuar të shfrytëzojnë hapësirën në fjalë, në këmbim të një qiraje mujore të dakorduar.

Përgjigje në ankesë subjekti politik AAK ka bashkangjitur si provë: Kontratën për dhënien në shfrytëzim për më pak se një (1) vit të pronës komunale të Komunës së Deçanit, me Nr. prot 10104, e datës 25.04.2025; si dhe Kontratën për lirin e hapësirave reklamuese, Nr. KO - 08/25, të datës 10.09.2025.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

- **Ankesa është e pa bazuar.**

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik AAK, vlerësoj se pretendimet e subjektit politik LVV, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Kjo për faktin se parashtuesi i ankesës i referohet shkeljes së dispozitës ligjore të lartcekur, publike konkretisht nën paragrafit 1.2 *“të publikojnë dhe të shpërndajnë afishe përmes shtandeve apo në hapësira publike, reklama dhe material tjetër lidhur me një fushatë zgjedhore”*, për rrugët “Agim Kukleci” dhe rrugë “Enver Haradinaj”, në Deçan-Pejë, mirëpo paneli në bazë të shkresave të bashkangjitura gjeti se provat nuk konstatojnë në mënyrë të qarte dhe bindëse se pamjet e ofruara në fotografi tregojnë rrugët e cekura në ankesë pasi që asnjëra nga rrugët e prezantuara në provat-fotot e dërguara nga ankuesi nuk janë të emëruara, dhe nuk mund të konstatohet nëse subjekti politik AAK ka bërë një shkelje të tillë në po këto rrugë.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nuk ka prova që e vërtetojnë se veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtuesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr. 91/2025 më datën 03.10.2025

Kryesuesi i Panelit
Skender Çoçaj



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykata Supreme të Kosovë, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.